



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:003537  
Datë: 23.10.2024  
Numri i dokumentit: 06338767

C.nr.2221/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses F.D. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Valdete Rudi, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 1,000.00, jashtë seance, me datë 23.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Fekrije Dinaj nga Komuna e Gjakovës, me cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, që në emër të pagës së 13 (trembëdhjetë), për vitin 2020, 2021 dhe 2022, t’ia paguaj shumën prej 1,000.00 euro, me kamatë prej 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja F.D. nga Gjakova, përmes të autorizuarit të saj Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, me datë 06.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën, me kontratë në kohë të pacaktuar me detyrat si Operatore në statistikë. Ka shtuar se paditësi në bazë të listës së pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, nga viti 2018 e deri në vitin 2021, ka pagën bazë prej 377.00 euro. Tutje ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës he Federatës së

Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, parashihet se “Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13-të (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”, e që dispozita e para cituar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13 lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë e paditura nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore, ku kjo është thënë edhe në mendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, për zbatimin e kontratës kolektive sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13 në sektorin e shëndetësisë, 212/2023, të datës 09.10.2023. Andaj, paditësja ka paraqitur padi ku kanë kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurin të bëjë pagesën e kompensimit në shumës prej 1,000.00 euro në emër të pagës së 13, për vitin 2020, 2021 dhe 2022, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbartimit si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj Valdete Rudi, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 15.10.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditësit nuk iu takon as me kontratën e punës, të parashkruar dhe të pathemeltë. Tutje kaka parashtruar se padisë së paditëses i mungon baza ligjore, pasi që bëhet fjalë për kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021. Ka theksuar se sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të KKS-së, e njëjta interpretohet duke u lidhur me ekzistimin e mundësisë për një shpërblim të tillë, siç ka paraparë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik me numër protokollit 212/2023, të datës 09.10.2023, andaj edhe i padituri SHSKUK si organizatë buxhetore ka pasur mungesë të buxhetit ndër vite në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, edhe përkundër planifikimeve, i njëjti asnjëherë nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tremujorin e fundit TM3 të çdo viti, vazhdimisht ka pasur deficit në paga dhe është plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta, siç provohet edhe nga njoftimi i lëshuar nga Drejtori Financiar i SHSKUK z. Enver Gashi, me numër protokollit 3823, i datës 21.12.2023. Po ashtu, ka parashtruar se edhe Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka mundësi buxhetore të bëjë kompensimin e shpërblimit për pagën e 13, siç provohet edhe nga përgjigja në kërkesë me numër protokollit 3610, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga U. D. i shefit të njësisë për buxhet dhe financa z. Murat Kursani. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se në mes të palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura, përkatësisht në punët dhe detyrat si operatore e statistikes po ashtu nuk ishte kontestues se e njëjta realizon pagë mujore bazë prej 377.00 euro.

Kontestuese në këtë rast në mes palëve ishte se a i takon paditësit e drejta për kompensimin e pagës së 13 dhe se a ekzistojnë mundësitë buxhetore të te paditurit për pagimin e pagës së 13, kundrejt paditëses.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, e datës 12.06.2018, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në aplikim nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2018, e cila në nenin 17 paragrafi 2 ka paraparë se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”. Në vlerësimin e dispozitës se cekur si me lartë, kjo gjykatë vlerëson se dispozita nga neni 17 paragrafi 2 e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, në përmbajtje lidhet me mundësitë buxhetore të punëdhënësit, pra e njëjta dispozitë nuk është e karakterit detyrues, përjashtimisht efektin detyrues e merr në rast se punëdhënësi ka buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për punëtorët e punësuar dhe që janë nën menaxhimin e tij. Pra, kjo e drejtë krijohet kur punëdhënësi (i padituri) nuk e përmbush këtë obligim, ndërsa nuk arrin që të provoj me asnjë provë se nuk ka pasur mundësi buxhetore për një kompensim të tillë.

Kësisoj, i padituri me rastin e paraqitjes se përgjigjes në padi, gjykatës i ka dorëzuar edhe provën materiale, nga e cila dëshmohet edhe gjendja financiare e tij në raport me buxhetin e pranuar vjetor për paga dhe mëditje

Nga njoftimi me numër 3823, i datës 21.12.2023, i lëshuar nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, përkatësisht nga Drejtori i Financiar z. Enver Gashi, vërtetohet se për vitin 2020, buxheti fillestar i alokuar për paga dhe mëditje për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, ka qenë në shumë prej 57,191,921.00 euro, ku buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 76,250,921.00 euro, ndërsa përfundimisht si institucion ka qenë në deficit buxhetor në shumë prej 19,059,000.00 euro

Pra, nga njoftimi i cekur më lartë, njoftim të cilin gjykata e vlerësoj të besueshëm dhe të plotë, marrë parasysh se i njëjti është i lëshuar po nga organi dhe personi kompetent lidhur me gjendjen buxhetore tek i padituri, u provua se mundësitë buxhetore të te paditurit nuk kanë qenë që e njëjta të veprojnë sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë. Andaj, gjykata kërkesëpadinë e paditëses në raport me pagën e 13 (trembëdhjetë) për vitin 2020, e refuzoj për shkak se i padituri nuk ka qenë në obligim në mungesë të mjeteve buxhetore.

Ndërsa, kërkesëpadinë për pagimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) në raport me vitin 2021 dhe 2022, gjykata e refuzoj për shkak se e njëjta kërkesë nuk kishte bazë ligjore, përkatësisht referuar aplikueshmerisë së Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se në kohën kur ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar një të drejtë të cilën mendon se i takon, kontrata e cekur si me lartë nuk ka qenë në fuqi, pasi që zbatimi i saj ka filluar me datë 11.06.2018, ndërsa përfundimisht ka përfunduar se zbatuari me datë 10.06.2021.

Pra, e drejta për pagën e 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021, do mund të kërkohej në muajin janar të vitit 2022, e po ashtu ajo e vitit 2022, do mund të kërkohej në muajin Janar 2023, andaj në këtë rast marrë parasysh përfundimin e zbatimit të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se kërkesëpadia lidhur me kompensimin e pagës se 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021 dhe 2022 nuk ka mbështetje në dispozitë ligjore materiale.

Gjykata analizoi edhe pretendimin e të autorizuarit të paditësit sa i përket asaj se e paditura ka pasur mundësi buxhetore për shkak se nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të të paditurës për vitin 2020, të njëjtës i ka tepruar 5% nga buxheti për të kompensuar pagën e 13-të, mirëpo një pretendim të tillë gjykata e refuzoi pasi që nuk pati ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore, për faktin se gjykata si me lart ka dhënë arsye bazuar në provat konkrete lidhur me pabazuashmerinë e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore të vendos jashtë seancës gjyqësore duke u mbështetur në nenin 399 të LPK-së, e cila parasheh që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, si dhe duke u bazuar në praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (rasti Jussia kundër Finlandës, nr.73053/01), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës, obligim i cili del nga neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e morri sipas nenit 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.2221/23, datë 23.10.2024

Gj y q t a r j a,  
Fëllanza Knushaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatë